

85.H-1

D 32

FAIK S. DEDA



ATDHEU DHE AI

8SH-1

8SH-1

S

FAIK S. DEDA

D 32

# ATDHEU DHE AI

(- SKËNDERBEU -)

- Poemë -

45598

BIBLIOTEKA E SHKENCË  
DHE ARTI  
GJITHSHKENCË

12094

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

«... Ai kurdoherë delte fitues  
mbi hordhitë e imperatorisë  
otomane, pse ai luftonte për  
lirinë, për independencën, për  
tokën.»

**ENVER HOXHA**



I

GJON' I THINJUR MBETI  
SI NJË SHKËMB MBI UDHË...

1. Varur  
Nëpër shkrepë,  
Kreshtave të thinjura  
Po krihen ujqvare.

Vijnë e gurgullojnë  
Legjendat  
Shqiptare.

Thellësira honesh,  
Një shqiponjë u ngrit,  
Ngjitet e rreh krahët  
Gjer në majë mali.

Melodi' e fyellit  
Brigjet ç'i flladit.  
Gurra popullore  
Rrjedhka si kristali...

2. Mes ngjyrash e jonesh,  
Zhytur nër jehona,  
Lashtësinë e vendit  
Ajo ma rizgjoi.

... Tej, n'ato lugina  
I paepur  
Balsha,  
Nëpër dallgë qëndroi.

3. ...Me vargje në buzë,  
Buzë ujvareve  
Pushoj.

Majë gërxhesh,  
Ja, sikur dalloj  
Gjin Bue Shpatën,  
Që ushtritë armike  
Turp e gjak  
— I ngjeu!

...Si kala  
Prej tyli  
Noton Narta;  
Trimi, jashtë saj  
Me rrufe u derdh,  
Turqit rreptë i theu...

4. ...Tri dekada luftë.  
Ballë hordhive turke,

Gjon' i thinjur  
Mbeti  
Si një shkëmb mbi udhë.

Lisi rrënjëshumë,  
Rri mburojë  
E rreptë.

Kur ja, për haraç  
Ju fanit Sulltani.  
Por ai e di:  
Veç kur shkulen rrënjët,  
Lisi mund ta ulë  
— Shtatin te dushmani.

5. ...Çast' i fundit erdhi:

Kruja  
S'njohu  
Një të tillë brengë!  
Më e madhe  
Dhëmbje  
S'ra mbi kraharorë!

— Katër pjesë zemre  
Sot do japësh peng.  
...Zemrën po ta shkulin  
At,  
O plak' i gjorë!



II

TUTJE NËR LIVADHE  
NIS TË THAHET BARI...

1. ...Dielli  
Zu të zverdhet.  
I ngjethshmi eklips  
Luginat i mbuloi.

— Djemtë ikën peng,  
Turku u afrua  
Heshti ligjërata e çdo kroi.  
... Lotët shterrën,  
Lëmshë në çdo fyt  
S'mund që të kaptohet...

— Mbahuni,  
Ju — nëna!  
...Toka mëmë drithmohet.

Trimat  
Po mendojnë.

— Mbahuni, ju — motra!  
Retë  
Gjak kullojnë.

2. ...Ndër lugina e male  
Zinë e hidhërimin  
Mbrëmja  
Ç'i pështjell.

Horizont i cekët  
Tej frëngjive shihet,  
Vetëm det' i heshtjes  
Duket kaq i thellë.

3. Për së gjalli  
Vrarë,  
Plaku Gjon s'ka gjumë;  
S'ka as lot, as fjalë.

Ullur mbi poltronë,  
Të mjerës Vojsavë  
— Tmerrshëm i ther gjiri.

Mal'i madh i dhëmbjes,  
Për çudi,  
E thinji...

4. ...Er' e jugut, vajshëm  
Fryn' e të këput.  
Tutje nër livadhe  
Nis të thahet bari.



...S'i mban vendi  
— Trimat.  
Shpata pret në myll.  
Shpatën e merr malli...

5. Shket gjysmake  
Hëna,  
Meket nëpër qiell.

...Burrat  
S'i merr gjumi.  
Ditët janë të lodhshme;  
...Pak,  
O-sa pak diell!

6. Dimri, parakohe  
Seç i thinji malet.  
Këngët  
— Sikur heshtën;  
S'ka as valle më!

...Dertet djegin zëmrat.  
Nata vjen e ikën,  
Po... asnjë nuk flë!

...Vetëm hon' i dhëmbjes  
Ësht' ngado i thellë.  
Arbëri e lodhur!  
Dita ngjan këmbanë,  
Nata —  
Si një shpellë!

III

NUK FLË LUM' I EGËR  
GËRXHEVE TË THEPURA

1. ...Qetësi minësh.  
Bota flë nën çallma.  
Hëna shket mbi çallma.

Gjergjit i shkon mendja  
Për një këngë malesh,  
Për një këng' epike...

...Nimfat shkasin butë  
Përmbi sixhadé.  
Digjet salltanet  
Harem' i Sulltanit.

— Netë anadollake.  
Ëndërrat më s'ja prishin  
Qetësinë dushmanit.

2. Hijet e minëve  
Të gjata, të thella.

Gjergjit nuk i flihet,  
Digjet në kujtime...

Mbi atdhe vërviten ré të zeza,  
Ndaj, çdo orë e çast  
Vret e ngjall mendime.

Për mëmëdhetarët  
Ç'e përvëloi malli,  
E përvëloi shumë!  
Thua se, vetë Gjonit,  
(Gjonit të pagjumë)  
Që nga thellësitë  
Gjithnjë ja ndjen zënë...!

Vargane mendimesh  
Në tru i lëvrijnë.  
...Ëndërrat e zgjuajnë,  
E lodhin, e mpijnë;  
Në zemër i flenë.

3. Mbi xhamitë e larta  
Netët ecin ngathët.  
Po ditët — të shpejta,  
Rrjedhin me nxitim.

Betejash të rrepta,  
...Zogut të shqiponjës



— I rrjedh gjak i kuq,  
Gjak nga Vendi trim.

...Netë pa hënë  
Vijnë e ikin prapë,  
Yje edhe derte  
Bien përmbi Tokë.

...Lajme vijnë nga larg:  
— Thellë në kreshta malesh  
Turku u bë copë!

Labi Aranit,  
Me një grusht komitësh  
Çallmat — n'erë i fluturon!

— Tundet gjith' Evropa  
Nga ju, sopotare!

Shkaba,  
Gjysmëhënë  
Tej o tej e shpon...

Sokoleshë Mamica  
Endet nëpër shkrepat  
Nga breron liria.  
...Vrau pashën turk.

Malet  
Mori trimja,  
E veshur si burrë.

Se, në këto brigje:  
Dhuna, robëria,  
S'kanë njohur rehat,  
S'janë duruar  
Kurrë!

4. ...Vjen prej thellësie,  
Një kushtrim nga malet tona  
Gjergjit thellë seç i kumbon...

«— O ju male,  
Me jehona!  
Larg nga ju, e paparë ju,  
Cili vallë, rron?!»

Si një gur  
Nis i rëndon  
Amaneti i të jatit:

— Kthehu, biri im,  
Pre vargojt e zinj  
Të Sulltan Muratit!

#### IV

...TROKU SA PUSHOI  
ATDHEU DHE AI.

1. ...Nishi —  
Përtyp hekur,  
Zjarre dhe kokalle.

Në betejë të ashpër  
Gjergji braktis Portën,  
Porsi gjëm' e madhe!...

Për në tjetër udhë  
Nget me vrap dorinë.

Shpatën tund në erë,  
Kthimin në atdhe  
E nis vetëtimë.

2. ...Malet, me bërryle  
Shtyjnë agimin para:  
— Ja, po vjen Ai.



...Pyjet pëshpërisin.  
Gurëve, kasolleve,  
Pa e parë Gjergjin  
— Nuk u rrihet dot...!

Ndizet ylberi.  
Mjegulla mbi pishat  
Derdh nga gazi  
Lotë...

3. Ja, ... Ai po kthehet.  
Dhe për në atdhe,  
Një të tillë revan —  
Epoka edhe malet  
S'kanë parë kurrë!

...Pelerin'e kuqe,  
Si kometë e zjarrtë  
Vazhdën lë  
Ballë erës...

Shqipja në flamur  
Farfurin — agimín.  
Popullit i jep  
Kushtrim ndaj skëtërrës.

4. — Shtatë ditë  
Udhë!

...Kali eci gjatë,  
Gjith' në fluturim.

...Troku sa pushoi.  
Atdheu  
Dhe  
Ai.

Kush në jetë provoi  
Një të tillë gëzim?!

5. Trim' i madh  
Ndalon  
Në një brinjë mali.

... Ulur buzë shkëmbit  
Çlodhet te një hije.

Bar  
Nga i atdheut,  
Sot përtypi kali.

Ujvaret e bardha  
Gjergji po dëgjon.

— O! moj tok' e ëmbël,  
Ti, çerdhe lavdie!  
Ç'mall të zjarrtë në zemër,  
Bijve u blaton!...

12034

~~45538~~

6. ...Ja, u nis për Krujë,  
E i hapin udhë  
Gurë edhe lëndina.

Nga Dibra vjen natën.  
Ç'po i dehin shtigjet,  
Dushqe dhe dafina...

Mes drurëve, doriun  
Përcjell nxitas  
Hëna.

Të lashtën Fortesë  
Mori prapë i zoti.

— Mblidhuni,  
Ju, burra!  
Mblidhuni, ju, nëna!  
Erdhi Gjergji ynë!  
Erdhi Kastrioti!



V

*Dhe në syt'e tyre  
Sheh rrufetë...*

1. Mbledhur në festim  
Një fushë shqiponjash,  
Nga Heroi shohin,  
Ngazëllimin derdhin...

Nënat,  
Nuset,  
Vashat,  
Lotë gëzimi fshehin.

...Herë-heshtj' e thellë,  
Herë brohoritje.

Dhe mali... dëgjon!  
Zemrat rrahin gjokset  
Tek çdo 'bir' e burrë.

— Fjala kastriote  
Përsëri ushton  
Në shtëpitë e flamurë!

2. Qiejve të largët  
Hija otomane  
Zhduket me vërtik,  
Porsi vetëtima.

...Gjer në majë — malesh  
Zëri burror ushton:  
«— O ju, kapedanë!  
Ju, ushtarë trima!...»

...Dhe ata gjëmojnë:  
— Ne, të tutë jemi!  
Me ty, përgjithmonë!

3. Përmes rrudhash — radhë,  
Prijësi po lexon  
Në ball' të tyre  
Një lavdi,  
Që shekujt do ndriçojë!

Dhe në syt' e tyre  
Sheh rrufetë,  
Që në çdo betejë  
Mbi gjith' Evropën  
Natën otomane  
Do coptojnë!

4. ...Gjoksin e mbush frymë,  
Edhe nëpër lisat .

Gjethet fëshfërinë...

.. Mbi malet  
Bie mbrëmja;  
Në çdo prag, — agimi.  
U mblodh kuvend' i parë,  
Ku lidhet si qëmoti,  
Një besë e re shqiptare.

5: ...U kthye vonë,  
Dhe nata ra të çlodhet.  
Kështjella ra në heshtje.

— E para natë  
Që nise një sy gjumë,  
O zulmëmadhja  
Shqipëri!  
O e palodhura  
Në përleshjet!

6. Po... nuk fleka maleve  
Jehona;  
Gjer në agim  
Ushton kushtrimi i lirisë,  
Gërxheve të larta,  
Në çdo breg:  
— «Lavdi, Luan' i Arbërisë!  
Na prij në ballë,  
O Skanderbeg »...



VI

*Malet lindin trima,  
Trimat rrinë rreshtuar.*

1. Ja, ushtria turke:  
Firomën i zë pyllit.  
Ngado vërshon potéré,  
E rreptë  
Edhe e rëndë.

Ja, Pashai turk:  
Krahun tund një herë,  
Kreun e ushtrisë  
E mbledh në tendë...

...Hëna, më të ikur  
Sikur don të fshihet,  
— Të mos shohë stuhinë.

Dhjetra mijë kalorës,  
Lisave pas shpine  
U ndjellin babëzinë...

Presin prapa tyre  
Mijëra këmbësorë.

...Fush' e gjerë  
Po plasaritet thellë.

Ky qershor  
I mblodhi prapë shqiptarët,  
Erdhën nga çdo prak.

...Te maj' e atij mali  
Agimi çel qepallat,  
Dhe shkëmbenjtë përballë  
I ngjyen gjak.

2. Vendi rri më këmbë.  
Shpata del prej myllit.

Malet lindin trima,  
Trimat rrinë rreshtuar.

Çdo zejtar a bujk,  
Djalë, a i moshuar,  
Bari, a druvar, —  
Sa bje brir' i luftës,  
Lë kopënë e sëpatën,  
Dhe me usht' e shpatë  
Zë vendin në radhë...

3. Nis e zjarrtë  
Beteja.  
Dheu po gulçon,  
Mali oshëtrin.

Pylli dridhet britmash,  
Ngjethet palc' e pemës,  
Moti vringëllin.

I paparë kurrë,  
Porsi miz'e lisit,  
Në drejtim të Krujës  
Derdhet i tërbuar  
Vrulli otoman.

...Egërsi' e tyre  
Zbutet përmes britmash,  
Thyhet përmes shpatash;  
Britmash  
Gjen shafran.

Nuk u soska  
— Turku!  
Sokëllim' e tmerrshme,  
S'paska të mbaruar...!

Ngrihet çdo shqiptar.  
...Nga alarm' i maleve,  
Thua — dhe të vdekurit  
Sonte... qenkan zgjuar,  
Sonte janë në radhë...!



4. Ja — shpat' e Skënderbeut!  
Po prin dymijë luanë,  
Që me tërbim të nderur  
Vërsulen befasisht...

Ushtat, nga çdo anë  
Vërshojnë  
E kryqëzohen,  
Ngulen çmëndurisht...

5. ...U lodh  
Dhe u vra,  
Tërë kjo ditë!  
Kjo dit' e djersitur...

Shpata grin e pret.  
Zjarri  
Veç zhurit,  
S'di, veç — të zhuritur!

Përleshja zhurmëmadhe  
Po për lan pangopur  
Përmes vringëllimash.  
Hon' i saj —  
I gjaktë,  
I zi dhe vigan.

Brigjesh e luginash,  
I fortë e dinak

Turku — mizëri,  
Ja... tek çapëlehet,  
Pa nam' e nishan!

6. ...Tutje, përmbi kreshta  
Kruhen kuaj reshë  
Lele — nxirë...

Kufomat —  
Radhitur...

Lisat dhe të vrarët  
Ranë në mugëtirë.

...Nis ashtu papritur  
Një puhiz' e ngrohtë;  
Nëpër djersë trimash  
Shkoi një veri...

Ranë në gjumë pishat.  
Malet  
Marrin frymë.  
...Pakëz  
— Qetësi.

7. Briri i fitores  
Jep të madhin lajm  
Përmes brohorimash.

...Jehona  
Në gërxhe,  
Këngë të ra për trimat.

Nër gryka thellë  
Luhatje sokëllimash...

8. ...Nga fusha e betejës  
Kthehen  
Fitimtarët.

...Për ata që ranë:  
Dhe lofatat n'udhë  
Dridhen nëpër ngjyra;  
Vjollcat,  
Trëndelinat,  
Ledheve lëshojnë  
Fërfërimë lirike...

Tunden ëmbël gjethet,  
Nënat edhe motrat  
Thurin këng' epike.

Për ata që kthehen:  
— Ligjërata zogjshë,  
Që nuk dinë të rreshtin.  
...Shkabat —  
Kaltërsive.  
Thëllëzat nër prozhme  
Ndalin e  
Venë veshin.



## VII

*Barinj edhe druvarë  
Gjokse llavëzjarrtë...*

1. ...Beteja ka mbaruar.  
Fitorja  
Prehet pakëz.

Mbi dori kaluar,  
Përsëndet ushtrinë  
Kryetrimi.

Në çast,  
Çdo gjë e gjallë  
— S'mund ta përmbajë veten,  
Dridhet nga gëzimi...

Melodi kreshnike,  
Mërmërojnë krojet  
Lugjesh, nga çdo anë.

Si ritmi i legjendës  
Pambarim,  
— Troku i kalit t'Tijë  
Mbi tokën-mëmë,  
Endet  
Anembanë.

2. Dielli  
Mbi kokat  
Pingul ra.  
Ulur rreth një rrase,  
Me ushtarët  
Gjergji,  
Drekën ha.

...Lajme aleatësh  
Mjegulluar vijnë.

...Venetiku kruhet.  
Strofkave të zeza  
Ndeshim dinakërinë.

Ëndër nëpër mjegull,  
Dinakëria s'flë.  
...Struket Vatikani,  
Zakonin  
— S'e lë.

Prapë, lakmi' e tyre,  
Bren edhe stërrallin.

— Dhëmbët mprehin tinës.

...Ujqër  
Rreth e rrotull  
Arbërisë i dalin.

...Ballërrudhur,  
Burrat,  
Gjergjin kanë rrethuar.

...Rrapin  
Rrënjëshumë  
Me të prerë degësh  
S'mund ta shkulësh  
Kurrë.

— Kështu, o Prijsi ynë,  
Të ndahet nga ky fis,  
Nuk mundet  
Asnjë burrë!

3. ...Rreth Gjergjit  
Janë mbledhur,  
Barinj dhe druvarë:  
Gjokse llavëzjarrta,  
Që derdhin gjith fuqinë!

...Rrahin



Armëtarët  
Ushta edhe shpata.

Pishat po dëgjojnë  
Fyellin, çiftelinë...

Këngët trimërore  
Qiejt zotërojnë.

Kodrave e lugjeve,  
Gurrat gurgullojnë  
— Kreshniket  
Melodi...

Honet oshëtijnë,  
Nginjur  
Gaz e bujë.

Nga brohoritj' e popullit  
Tundet i gjith' dheu:

— Gëzohu, Arbëri!  
— Hiqe vallen, Krujë!  
Në ballë prin —  
I palodhuri,  
I yni,  
— Skënderbeu!

VIII

*Shpatat çaj në natën,  
Trimat — erën çaj në...*

1. Muzgu  
Përsëri po humbet malet.  
Nata vjen  
— E errët,  
E menduar...

Gjergj Kastrioti  
Me një çetë trimash,  
Ndodhet krejt papritmas  
I rrethuar...

2. ...Asgjë s'pipëtin.  
Nata fle e thellë.

Pabesia  
Çlodhet,  
Dremit në luginë.

Oqean' i heshtjes  
Në mistere dridhet.

Zëra kukuvojke  
Rrall' e tek vijnë...

3. ...Errësira çahet,  
Çahet e rënkon.  
— Mbi dorinë e dirsur,  
Mendjevetëtima,  
Tutje nget revan.

Çetën e rrethuar,  
Guximshëm e çon  
Një nga të shtat' trimat  
Në të tijne stan.

4. ...Zilet hiqen nxitaz;  
Brirët e çdo dhie  
U lyen rrëshirë,  
Dhe te shteg' i shtrungës,  
Nëpër çdo bri dhie  
Shpejt po vihet flaka...

— «... Ruajna, o Zot!»  
— «... Nata u ndez zjarre!»  
— «... U ndez zjarre — nata!»

Pyllit,  
— Vrap' i dhive



Ngjan si sulm' i vrullshëm  
Nga skalion' i dytë...

Ngjan ajo vërsulje,  
Si stuhi e rreptë  
Trimash të harbuar...

Pa, ... ç'të shohin sytë:  
— Përmbi kuaj  
Vrap!  
Turqit po ua mbathin,  
Ikin të tmerruar...

— «... U turr Iskanderi!»  
— «... Yxhym! — kthejmë prapë...»  
Dhe... në rrëz' të malit  
Mbajn' të fundit hap...!

5. Ndërkohë, nga çdo anë  
Jepet shpejt kushtrimi.  
Fshatarët ndër male  
Fshehtas lajmërohen.

...Shpatat çajnë natën.  
Trimat —  
Erën çajnë,  
Dhe me Kryetrimin  
Për në sulm rreshtohen.

...Hasmit t'çoroditur,  
Nga s'e pret  
I dalin.

**Pa zbardhur agimi,  
Nis me vrull beteja.**

...Të përpjetës malit  
Turqit shpartallohen.  
— Në të zezat éthe  
Dridhet Endreneja.

6. ...Zbardh  
I bardhë agimi.  
Nër lugje, nër kreshta  
Nisi çiftelia.

Natyra fundoset  
Nëpër cicërima.

Nër pllaja,  
Luledelet  
Po i puth puhia.

...T'ëmbëlat blegërima  
Nisën nër zabele...

...Q'ahere, Gjergji  
Stemë kokëdhie —  
Mban përmbi kapele.

IX

*...Zbehen vetëtimat  
Kur vërshojnë shqiptarët.*

1. ...Dimër.

Heshtin  
Malet e mbuluar dëborë;  
Rreth e rrotull  
Vetëm mjegullirë.

Murrëri  
Villet nga thepat shkëmborë;  
Ulërin parreshtur,  
Të këput si thikë  
Në këtë të ngrirë...

2. ...Jepet shpejt kushtrimi.

Britmash turkoshake,  
Veshët i shurdhohen  
Edhe motit!



Shpateve malore,  
Shpatën zhveshur  
Nget revan  
Ushtri' e Kastriotit.

3. Pa vërsulet rreptë  
Kalorësia turke,  
— Suferinë e fortë.  
Thua se dhe qiejt  
Me krah' do t'i marrë!

Gjaku mbulon gjurin.  
Po..., s'ka dallg' a shqotë,  
Që t'i mbajë në vend  
— Barinj e druvarë...

4. Kuajt në revan  
Vërsulen si trimat,  
Të dalin të parët...

«— Qen, o jeniçerë!»  
...Zbehen vetëtimat  
Kur vërshojnë shqiptarët.

...Dhelpra plakë,  
Tek tenda  
...Njohu ulërimat!  
— Dridhet edhe vetë,  
Çirret, ulërin...

Me shtatë gjuhë  
Të rrepta,  
Era rreh mbi lisat,  
Era fishkëllin...

5. Kuaj reshë  
Mbi maja malesh  
Shtyhen...;  
Kruhen midis tyre,  
Dhe... harbuar ecin.

Sipër gërxhesh  
Vriten vetëtimat.  
Prapë, në gërxhe —  
Thyhen  
Edhe ngecin...

6. Shpata  
Vërshëllen mbi otomanët.  
Krahu tund  
Dhe lirin me shumë rrënjë.

...Lukunja turke  
Po kthen krahët...  
— Babëzi-u  
... Çirret, s'din ç'të bëjë...!

7. Mbi mburoja,  
Thyhen varg shigjetat;  
Shpata dridhet n'erë,

Ngulet,  
Vetëtin...

...Ja, dhe ajk' e fundit,  
Sulet me tërbim:  
— «Hya!... bëni — ballë!  
O — Allah!...»  
Yxhym!...»

... Habitet Sulltani:  
— «Si luftoka, vallë  
Arnaut fshatari?!?»

...Si vërsulje  
Shqote,  
Ndjen një ulërimë.

Pa, gjëmon shqiptari:  
«— Në ball' të mejdanit,  
Pabesia jote  
Veç me gjak do shlyhet,  
Shpat' e vetëtimë!»

9. ...Mbrëmja  
Vjen e plogët,  
Lodhur e dërrmuar...

Drejt Oborrit,  
Kthehet turpmbuluar  
Çerek' i ushtrisë:



...Bishti,  
Q'e për lau  
Më e madhja brengë!

...Nga një gjarpër zjarri  
Që mes malesh shkau,  
Rrapit iu zhurit  
Më e gjera  
Degë.

X

*Në muzg e në mendime,  
Dy male zhyten thellë...*

1. Atje, ku nga bedenat  
Sheh rrashtet kodrinore  
Dhe lumin gjarpërus  
Që zgjatet larg,  
— Fillin zë  
Legjenda popullore,  
Nga goj' e bardit plak...

.....

Në muzg  
E në mendime,  
Dy male  
Zhyten thellë.

...Ulur sipër shkëmbit,  
Gjergji po mendon.

Brethuar në kështjellë,  
Uria bren ushtrinë  
Dhe, edhe gurët  
Zë e i sharron...

2. Po kruan mjekrën  
Plaku Koke Malçi;  
Vështrimin  
Tret luginash.  
Pa, nis t'i flasë Prijësit.

— O burr i urtë,  
I tokës së pavdirë!  
O trimi Skënderbe!

...Me grurë,  
Një mushkë  
Ta ushqejmë mirë,  
Dhe nga bedenat hidhuani  
Atje...

3. ...U ça ky bark' i mushkës,  
(Rojet i rrin' pranë!)  
Dhe kokërrat e grurit  
Jasht' i dalin.

Turqit mbledhin supet:  
— Kaq shumë bereqet  
Arnautët kanë,



Sa... edhe kafshët  
Me grurë po i majmin...!

4. Në tendën e shtabit  
U mblodhën këshillëtarë.  
Papritur shtur rrethimin  
Hordhi' e çoroditur.

...Shpërthen kështjella.  
Vërsulet kal' i bardhë...  
Nga pas e ndjekin trimat,  
Malin duke ngjitur.

5. Grykave të egra,  
Brinjave,  
Ndër lugje,  
— Lukunia turke  
Gjen një fund të hidhur,  
...Korbat po ushqen.

Edreneja ngjethet:  
Si jehonë e ngjirur,  
Ngashërim' i Pashës  
— Sulltanit i vjen.

XI

*Shkëmb që rrokulliset:  
Gjergji prin fshatarë..*

1. ...Thikat e shkëmbenjve  
Mprehu er' e natës;  
Mantel' i saj i zi  
Kreshtave u gris,  
Humbi në luginë...

Kali — érë!  
I Gjergjit,  
Pret të hapë sulmin;  
Dheun rreh me këmbë,  
Hidhet,  
Hingëllin...

2. ...Agimi,  
Me maja malesh  
Ngadalëz zë të puthet.

— Ngjyhen në të kuq  
Shkëmbenjt' e Arbërisë.

...Mjegulla, mbi bredhat  
Me nxitim u tret.

Fushën  
Na zaptoi  
Hordhi' e Turqisë.

...Nëpër krahë gërxhesh,  
Ushtri' e Skënderit  
Kushtrimin po pret.

3. Karshi njëri-tjetrit,  
Dy male po rrinë.  
...Malet nuk takohen.

Dy ushtritë  
Rreptë,  
Ndeshen në luginë.

Fshatarët —  
S'ndalohen.  
Hidhen egërsuar,  
Këmba s'u zë dhé.

— Trima të harbuar.  
... Shpata kullon gjak.  
Syri derdh rrufé!



Përmbi çallmën.  
Shkaba —  
Sulet vetëtimë!

— Ku e paska fundin  
Ky tërbim' i ndezur,  
Gjithë kjo vringëllimë?!...

4. Kështjella  
Nis këlthet.

Dielli,  
Humbur e harruar  
Përmes reshë e gjylesh,  
S'dihet  
Ku qëndron.

Sulltan' i egërsuar,  
Fortesën kastriote  
Rreptë e rreh,  
E rreh dhe e gjymton.

Topat  
Vjellin hekur,  
Edhe hekur  
Bluajnë.

... Malet zën' e shkunden.  
Trimat, porsi trimat,  
As qepallat s'luajnë!

5. ... NËpër gryka malesh,  
I madh e i vogël —  
Or' e çast armikun  
Për vdekje godasin!

Gurë rrokullisin,  
Vërviten mbi hasmin,  
— Karvanet dërrmojnë.  
Kur... mbarohen gurët,  
Shkëmbin zënë thërrmojnë!

6. ... Shpata edhe ushta  
Çaj në prapa shpine.  
— Dridhet gjith' fortesa  
Nga klithm'e gjëmime.

Ja, në krahun tjetër  
Sulet kal' i bardhë...  
O burra, ushtarë!

Shkëmb që rrokulliset:  
Gjergji prin fshatarë,  
— Zjarr e bubullimë!

— Ngriu otomani!  
.. Nga s'e priste kurrë,  
Skënderbeu ynë,  
Derdhi lemerinë  
Porsi llavë vullkani!...

7. Kruja  
Ngre flamurin.  
...Shall të kuqërremtë  
Hodhi perëndimi.

Malet ranë të flenë.

...Turku përtyt veten.  
S'ka  
— Si hidhërimi!

...Lodhur e menduar,  
Shqipëria flë.  
Zgjuar: armëtarët!  
Se në gjumë — shqiponjat,  
Lavdia s'i vë.



XII

*...As gurët e udhës  
Tradhëtinë s'e falin.*

1. ...Dita  
Këmben Natën.  
Nderi  
Ësht' i bardhë.  
Turpi është' i zi.

Armikun  
— Litari.  
Tradhëtarin — hûri!

...Kundër vendit t'tij,  
Turkun mizëri  
Befasisht e pruri,  
Ballabani trim.

2. Pa nisur beteja,  
Gjergjit seç i vijnë  
Bakshishe me vlerë.

— Ja, o princa t'Arbërit,  
Tradhëtari ynë  
Po na bën një... «nder!»

Dhuratat vështroni!  
...Çojani, dhe ju  
Një «shpërblim» me vënd!...

Po, mos e harroni:  
Edhe kur jep shpirt,  
Ujku...  
— S'bëhet qëngj!

3. — Nisni... një lopatë,  
Shatin dhe një pluar.  
...Eh, sa mirë  
— Si bujk,  
Të kishte punuar!...

Kundër vendit t'vet,  
Cili pati fat?!  
...As gurët e udhës  
Tradhëtinë s'e falin.

...Mirë do ish në fshat.  
Nami dhe lakmia  
Hundësh do t'i dalin!

4. Dhe ashtu i doli.  
...U thye me karvanet,  
I pabesi — Ballaban.

Mali përkarshi,  
Sheh si sulen trimat  
Rrëke nga çdo anë.

...Krymb' i tradhëtisë  
Zemrën e cenos,  
Trupin e gërryen.

Po, në shkëmb të fortë  
Krymbi zë e krymbet,  
Kokën démi thyen.

...Ballabani — rob,  
(Me një vesh të prerë)  
Rri, mërzen  
Nën turp.

Turpi  
Gëlltit vrer.



### XIII

*... U thinj përmes shkrepash,  
Përmbi zjarre lufte.*

1. Mbi një fushë të tërë,  
Vapa përvëlton;  
Vetëtimthi mbledhur  
Në kuvend të gjerë,  
Prijsi me fshatarët  
Shtruar kuvendon.

Vapa ndez në etje  
Njerëz rritur malesh,  
Të fortë si stërrallë.

Gjergji, inatosur  
Nxjerr shpatën nga mylli,  
Pran' zallit e ngul  
Me fuqi të rrallë.

Pa shpërthen me vrik  
(Atje ku u ngul shpata),

Si curril argjëndi —  
Uj' i atij dheu ...

...Urtësia  
Shkroi  
Edhe një legjendë.  
Përmbi mal u ngrit  
Emr' i Skënderbeut.

2. Ja, ..mbrëmja afrohet  
Ngadal' dhe e qetë.  
U lodhën malet.  
Me gjak rrezesh  
Ngjyhen tutje retë...

Ngjyhen retë tutje.  
... U thinj edhe Ai.  
U thinj përmes shkrepash,  
Përmbi zjarre lufte.

3. Lavdia,  
Më katërsh po e ndan  
Tërë atë shekull;  
— Mbi njëzet beteja  
Gdhendi në një pjesë.

Mbi këtë tokë,  
U shkrua zjarr e hekur,  
I madhi «Mot i Arbërit»,  
Që nër mote  
— S'vdes!

4. ... Në kërtëzë të dimërit,  
Në zhurmën e trokut,  
Dergjet Kryetrimi.

... E bardha mjekër  
Hapur  
Krahërorit...

Malet  
Nuk ankohen prej thëllimit...  
Nisi nga legjendat  
Fyell' i malësorit.

5. Dhe në shtrat ku dergjet:  
Mendja  
Sheh mbi hartën,  
Zemra  
Rreh për malet,  
Krahu  
Kërkon shpatën,  
Fjala ndez dhe natën!

6. ...Ditët  
Mezi ecin.  
Prapë, — e thella dhëmbje  
Nisi t'i rëndojë.

— Shpatën  
Kërkon Gjergji.



Larg saj,  
Dhe pa'të —  
S'mund as të lëngojë!

... Bën të ngrihet  
Gjergji.  
Mendja shkon mbi lugjet,  
Zemra rreh për arat.

Prapë, e thella dhëmbje  
Shpirtin po ja plas,  
E bën të rënkojë.

... Thërret një fshatar.  
Don të ngrihet Gjergji, —  
Shpatën të godasë,  
Plorin të punojë.

## XIV

— Çlodhu,  
A i lodhuri aq shumë'

1. Qielli —  
Pus paanë,  
Erret me nxitim.

— Seç do ket' një hall.

Yjet,  
Pa përtim,  
Pse kjo natë, vallë,  
Mbi Tokë po i rrëzon?!

— Vdekja,  
E lodhur nga vargmalet,  
Gjergjin po kërkon.

2. — Sa e zezë  
Kjo natë!

... Gjumë sonte s'ke,  
Nëna — Shqipëri!

... Thellë të dhëmb në gjoks.  
Trimja e paepur,  
Hallemadhja — ti!

Heshtje muresh  
Në Kalanë e Lezhës.  
Ndjen toka  
Të dridhur.  
... Trimat rreth e rrotull  
Heshtin besëlidhur.

3. . . . .  
Heroi mbylli sytë.

... Netëve,  
Për pesë shekuj,  
Që sonte  
Zuri fill pagjumësia.

Malet  
Drodhën supet,  
Kodrat u rrënqethën;  
Honet psherëtinë  
Që nga thellësia.

4. Nga çdo gjethe lisi  
Po pikonte lot.



Nga çdo sy shqiptari  
Derdhej një rrëké.

... E përgjakur  
Hëna  
Ecte mbi Atdhe.

Heshtja nëpër pyje  
Ish e thellë,  
E gjatë.

... Gurrat  
Ndalën vrapin,  
Atë natë...  
— O, ç'natë!

5. Nër majëmalet  
E ngarkuar borë,  
Si t'ish një vetëtimë e zezë,  
Përshkoi zia.

...Moti  
Heshti.

... Të fundit  
Frymëmarrje,  
Nga gjoks' i Tij shkëmbor,  
E ndjeu atë çast  
Gjithë Shqipëria.

6. ...Kalit famëmadh  
Seç i dridhet perçja,  
Rreh e turfullon.

...Drithmohet  
Parreshtur  
Buz'e çdo njeriu.

Çdo njeri,  
Mes lotësh  
Shpatën  
E shtrëngon.

7. Qe e madhe dhëmbja,  
Kapërceu malin.

Burrat lidhin besën.  
...Kali përtyp dhëmbjen,  
Dhëmbja po bren kalin...

8. Kështjellat dhe njerëzit  
S'paskan sot të heshtur.

... Trimat  
— Tokin duart.  
Shpata rri e ngjeshur.

Përballë —  
Hordhia turke!

...Shpata duhet çveshur.  
Dhëmbja  
Do harruar.

Për Vendin  
Që e lindi trimërinë,  
Lavdia —  
Nuk mund të ketë kurrë  
Të mbaruar!

9. Dimër.  
... Preu flokët mali,  
Kruja plagëkuqe  
Vu shami të zezë.

Përjetësisht  
I mbylli sytë Vigani.  
Ra në gjumë.

Lumenjtë e Arbërisë,  
Tok me revanin,  
Nisën ligjëratën:  
— Çlodhu,  
A. i lodhuri  
Aq shumë!



XV

*Malet — u rrafshuan!  
Po, trimat s'mbaronin.*

1. ...Muzgu  
U vais  
Nër gryka malesh.

Humbur thellësishë  
Nëpër jehona,  
Shkëmb' i Vajës, vajin  
Lehtas mërmëron...

Honeye të zeza  
Flenë ashpër  
Vajzat trimëresha...  
Bardhësi' e nderit  
Butas i mbulon.

2. Jeta kërkon luftë.  
Lufta grin e pret...

Po,... dallgët s'pushojnë  
— Në popull, në det.

Rrotull zjarresh,  
Ngrohen nëpër net  
Zemrat shqiptare;  
Trimëritë e hershme  
Parreshtur tregojnë.

...Nënat shamizeza,  
Vajzat sogjetare,  
Në gosti e dasma  
— Gjergjit i këndojnë..

3. ... Toka  
Zien.  
Planeti ynë  
Nuk e duron lëngatën;  
Noton e madhërohet  
Nër dallgë  
E suferina...

Pa e harruar shpatën,  
Koha  
Ecën,  
Mbarsur me kushtrim  
E vetëtima.

4. ... Planeti zien.

Liria

Po skuq vitet.

E kuqe — kjo Kala!  
Dhe shpata e Gjergjit,  
Shpat' e prerë nga malet  
Kurrë s'do venitet.



## XVI

— *Enverit t'i jap dorën,  
Popullin ta ngjatjetojë...*

1. ... Shekujt rrodhën varg.  
Nëpër shkëmbenj'  
E trollit amëtar  
U gdhend pas çdo rrebeshi,  
I lashti  
Dhe i rrepti,  
Emër — «Shqiptar!»

Me plumb në ballë!  
— I pritëm ne  
Hordhitë.

... Brigjeve  
Të xhvokshura,  
S'u shterën kurrë  
Dallgët e stuhitë.

2. Tek kjo tokë e moçme,  
Nga hallet rrudhur

E rrahur —  
Ditëve nga suferinat,  
Dhe netëve nga deti,  
— E çuditur pa bota:  
... Trojet q'u rrafshuan,  
Kalat' q'u thinjën,  
Edhe përmbi 'to —  
Shqiptarin e paepur  
Që maj' shkëmbit  
Mbeti!

3. ... Me një gunë pështjellë,  
Nga llohërat i argasur,  
Shkrepave  
E vriste shqiptari  
— Errësirën e thellë  
Të shekujve buzëplasur.

... E vriste,  
Me gjak të pasosur  
E këngë trimërie,  
Në dridhje fyelli,  
Në tinguj çiftelie.

4. Me armiq të egër,  
Kastriotët  
E rinj  
U kacafytën rreptë,  
Në këta male të lartë.

Kushtrimin —  
Dha Partia.

... Derteve pambarim,  
U erdhi fundi  
Mes vetëtimash,  
Të moteve të zjarrtë.

5. Si vet rrjedh' e gjakut,  
Palash të Flamurit  
Valvitej krenare,  
Në çdo skaj t'atdheut  
— Lavdia partizane.

Dhe më tej u çua  
Fam' e Skënderbeut.

...Ai.  
Pushoi gjatë:  
Si lapidar graniti  
Mes maleve shqiptare.

6. Kaluar sot na vjen,  
Nga lartësi lavdish  
Q'e ngriti Shqipëria.

...Ndalon në majëmalet,  
Zbret të puthi tokën,  
Dhe lot i venë



Nga malli,  
Gëzimi,  
Krenaria...

Mes mjegullës së kohërave  
— Dëgjoni trokun:  
...Ai po vjen!

E mbajti vrapin si shqiponjë  
— Atdheut t'i puthë ballin,  
— Enverit t'i japë dorën,  
— Popullin ta ngjatjetojë!

1965-1967

---

45588

BIBLIOTEKA E SHTETIT  
GJIRKASIA

1988-1981

Tirazhi 1500 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

Shtyp NISH Shtypshkronjave «Mihal Duri»  
Stabilimenti «8 Nëndori» — Tiranë, 1968